



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3110/7 prot

Datë 09.01.2024

**V E N D I M**

**Nr. 26 / 2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.01.2024 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ALCANI” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-88685-11-22-2023, me objekt “Blerje dru zjarri dhe Pelet, për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë”, me fond limit 3,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Rrogozhinë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “ALCANI” SHPK me Nipt J91505006Q  
*Adresa: Rruga e Laknasit, Blloku Frutikulturë 100 m pranë urës, Kamëz.*
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Rrogozhinë.  
*Adresa: Lagjja 1, Rruga e Kavajës.*
- Subjekt i Interesuar:** Operatori ekonomik “Gjergj Buça” P.F me NIPT K31331547R dhe adresë “*Ura Dajlanit*” Durrës.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet pretendimet e ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.11.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-88685-11-22-2023, me objekt “Blerje dru zjarri dhe Pelet, për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë”, me fond limit 3,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Rrogozhinë.

II.2. Në datën 04.12.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues, rezulton, se në datën 06.12.2023 është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

1. “ALCANI” SHPK	2.512.500	lekë	skualifikuar
2. “Gjergj Buça” P.F	2.992.500	lekë	kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se në datën 07.12.2023 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

Sipas këtij formulari operatori ekonomik “ALCANI” SHPK rezulton i skualifikuar për arsyen si vijon:

*“Arsyet e refuzimit të ofertës janë për mospermbushje kriteresh si më poshtë:  
2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme në lidhje me mallrat objekt prokurimi të vlefshme në momentin e hapjes së ofertave:-leja mjedisore e paraqitur pa vule elektronike dhe pa koken e shkresës*

*2.3.4 Operatori duhet të ketë në pronësi ose në përdorim kundrejt kontratave perkatëse të noterizuara ambjent të përshtatshme për magazinimin e produkteve objekt prokurimi, për këtë qëllim operatori duhet të deklarojë vendndodhjen e mallit dhe gjendjen aktuale të mallit që kerkohet, në mënyrë që të mund të verifikohet nga AK-ja-nuk është paraqitur as certifikate e pronësise ,as kontrate qeraje nese ka.*

*2.3.5 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose në përdorim kundrejt kontratës perkatëse të noterizuar, mjete transporti të vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës si më poshtë:*

- Te paktën një Automjet të përshtatshëm me kapacitet deri 3.5 ton për transportimin e druve të zjarrit.*
- Te paktën një Automjet vetëshkarkues me kapacitet deri 3.5-7.5 ton për transportimin e druve të zjarrit.*

*Per automjetet në përputhje me kodin rrugor të paraqiten certifikatat e pronësise, si dhe dokumentacioni perkatës; siguracioni, leja e qarkullimit, aktin e kolaudimit të automjetit në dispozicion-2 mjete të paraqitura janë mbi tonazhin e kerkuar. AA75ITS-12.5 Ton deri në 18 Ton dhe TR7261K-10.3 Ton deri në 16 Ton..”*

II.5. Në datën 14.12.2023, është paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ankesa e operatorit ekonomik “ALCANI” SHPK me nr. 3110 prot., për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i saj lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “ALCANI” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 3110/2 Prot., date 15.12.2023, duke referuar arsyet mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “ALCANI” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Me shkresën nr. 4449/1 prot, datë 20.12.2023 prot., protokolluar me tonën me nr. 3110/4, datë 21.12.2023, me objekt “ Informacion” është dërguar pranë KPP-së, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “ALCANI” SHPK, nga ku rezulton, se ky i fundit ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.8 Në përputhje me nenin 113 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” pranë KPP-së ka mbërritur shkresa me nr. 10 Prot., datë 16.12.2023, protokolluar me tonën me nr. 3110/3, datë 20.12.2023, me objekt “Argumentimi si operator i interesuar”, nga operatori ekonomik Gjergj Buça P.F.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “ALCANI” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Në lidhje me kundërshtimin e arsyes së parë të skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, se *Arsyet e refuzimit te ofertes jane per mospermbushje kriteresh si me poshte: 2.3.2 Operatori ekonomik duhet te disponoje certifikatat e meposhtme ne lidhje me mallrat objekt prokurimi te vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave:-leja mjedisore e paraqitur pa vule elektronike dhe pa koken e shkreses “*

*Argumentet e ankimuesit në mënyrë të përmbledhur si vijon [...] në SPE ne kemi ngarkuar Leje Mjedisore Tipi B (III.I.B) me date lëshimi 21.04.2022 nga Ministira e Turizmit dhe Mjedisit*

*përkatësisht nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Ju sqarojmë se Leja Mjedisore që ne kemi ngarkuar në sistem është marrë nga QKB nga e cila nuk diskutohet origjinaliteti dhe vlefshmeria e dokumentit dhe është e dorëzuar nga ministria e gjithë praktika „... ajo është e rregullt ndaj arsyeja e skualifikimit nuk qendron. Nëse KVO nuk e ka të qartë mund ta aksesojë dokumentin nga QKB sipas deklaramit të formularit të vetëdeklarimit...[...]*

III.1.2. Autoriteti kontraktor në DST ka publikuar shtojcën 7, 2. Kritere të Veçanta të kualifikimit, 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme në lidhje me mallrat objekt - prokurimi të vlefshme në momentin e hapjes së ofertave:

- Certifikatë: Sistemi menaxhimit të cilesise (ISO 9001)
- Certifikatë: Sistemi menaxhimit të mjedisit (ISO 14001)
- Certifikatë: Sistemi menaxhimit të shendetit dhe sigurimit në punë (OHSAS- 18001)

Leje mjedisore nga QKB.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.1.4. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se:

*“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.*

III.1.5. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat mallrave” pikat 5 dhe 8, të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

*5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

*8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.1.7. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, operatori ekonomik “ALCANI” SHPK në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur dokumentin emërtuar:

*Leje\_mjedisore\_tipi\_\_B\_\_\_-ALCANI\_SHPK* ku ka depozituar:

- *Lejen Mjedisore Tipi B, Për “ALCANI” SHPK me Nuis/Nipt: J91505006Q , me nr. PN-1159-04-2022, Kodi: III.1.B me datë lëshimi: 21/04/2022, Afat vlefshmëria : Pa afat..*
- Gjithashtu, bashkëlidhur edhe dokumentin:

*Nr. 3730 Prot*

*Date. 20.04.2022*

*Akt-Miratimi*

*Leje Mjedisore Tipi B,*

*Lëshuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Me Firmë të Ministrisë Mirela Kumbaro Furxhi, ( praktika në total 33 faqe ).*

Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me plotësimin e kriterit më sipër, ka kërkuar përveç certifikatave edhe Leje Mjedisore nga QKB. KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik “ALCANI” SHPK ka plotësuar kriterin e mësipërm të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, pasi nga verifikimi i përmbajtjes së dokumentit rezulton, se dokumenti është në përputhje me kriterin e kërkuar. Gjithashtu referuar të dhënave nga QKB, shfaqet një listë me leje aktive në emër të operatorit ekonomik “ALCANI” SHPK si vijon:

Lista me licencat aktive të subjektit:

***Numri i licencës***

***Licenca***

***PN-7407-06-2014***

***Leje Shfrytëzimi***

<i>PN-5483-05-2013</i>	<i>Leje e thjeshtë mjedisore</i>
<i>PN-1159-04-2022</i>	<i>Leje Mjedisi e tipit B</i>
<i>LN-1154-03-2010</i>	<i>Shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyje dhe/ose kullota</i>
<i>LN-7937-05-2014</i>	<i>Prodhimi dhe/ose tregtimi i farave dhe/ose fidanëve</i>
<i>PN-6554-12-2013</i>	<i>Leje mjedisore</i>
<i>LN-8002-07-2019</i>	<i>Veprimtaritë e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis</i>

Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër thekson, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ka përmbushur kriterin kualifikues me paraqitjen e dokumenteve provuese cituar më sipër. Për më tepër, KPP vëren, se legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në dokumentet standarde të tenderit edhe të drejtën e verifikimit të informacionit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to.

Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

### III.2 Në lidhje me arsyen e dytë të skualifikimit:

*“2.3.4 Operatori duhet të kete ne pronesi ose ne perdorim kundrejt kontratave perkatese te noterizuara ambiente te pershtatshme per magazinimin e produkteve objekt prokurimi, per kete qellim operatori duhet te deklaroje vendndodhjen e mallit dhe gjendjen aktuale te mallit qe kerkohet, ne menyre qe te mund te verifikohet nga AK-ja, nuk eshte paraqitur as certificate e pronesise, as kontrate qiraje nese ka.”*

III.2.1. Autoriteti kontraktor në DST ka publikuar shtojcën 7, 2. Kriete të Veçanta të kualifikimit, 2.3 Kapaciteti teknik,

pika 2.3.4 Operatori duhet të ketë në pronësi ose në përdorim kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara ambiente të përshtatshme për magazinimin e produkteve objekt - prokurimi, për këtë qëllim operatori duhet të deklarojë vendndodhjen e mallit dhe gjendjen aktuale të mallit që kërkohe, në mënyrë që të mund të verifikohet nga AK-ja.



III.2.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “ALCANI” SHPK SHPK, në Sistemin e Prokurimit Elektronik, konstatohet, se në përmbushje të kriterit të mësipërm ky i fundit ka dorëzuar: dokumentin emërtuar:

*Deklaratë-për\_ambiente\_dhe\_mallin\_gjendje\_B\_Rrogozhinë.* Referuar deklaratës së operatorit ekonomik ankimues ka deklaruar (në mënyrë të përmbledhur) *në lidhje me ambientet që ka në pronësi në dispozicion për magazinim të mallit dhe ruajtjen e tij, ka deklaruar sasinë në m<sup>3</sup> të mallit dru zjarri dhe sasinë në Kg të mallit pellet druri, adresën e shoqërisë dhe vënie në dispozicion të ambienteve mbi verifikime të deklarimeve të tij.*

III.2.3. Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se Autoriteti kontraktor është përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim me synimin kryesor që t’i shërbejë AK-së për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Referuar arsyes së skualifikimit dhe pretendimeve të ankimuesit ku argumenton se : *[...Shkresa e vetëdeklarimit e firmosur dhe vulosur e ngarkuar në sistem është siç e ka kërkuar AK në DST. Për sa i përket certifikatës së pronësisë apo kontratë noteriale, këto dokumente nuk janë kërkuar në DST për t’u ngarkuar në sistem, por ato kërkohen pas shpalljes së fituesit....]*, Komisioni vëren, se operatori ekonomik me të drejtë ngre pretendime duke kundërshtuar arsyen e skulifikimit, pasi kërkesa për deklaratë është përmbushur prej tij.

Gjithashtu, referuar kritereve për kualifikim, Autoriteti Kontraktor në kriterin kualifikues kërkon: pika **2.3.4** *Operatori duhet te kete ne pronesi ose ne perdorim kundrejt kontratave perkatese te noterizuara ambjent te pershtatshme per magazinimin e produkteve objekt prokurimi, per kete qellim operatori duhet te deklaroje vendodhjen e mallit dhe gjendjen aktuale te mallit qe kerkohet, ne menyre qe te mund te verifikohet nga AK-ja.*

Komisioni, referuar kriterit 2.3.4, vëren se autoriteti kontraktor ka kërkuar që *OE të deklarojnë se duhet të këtë në pronësi ambient për magazinim..., vendndodhjen e mallit... gjendje aktuale.. e më pas mundësi verifikimi*, pra AK kërkon deklaratë dhe nga ana tjetër skualifikon ankimuesit me arsyen se *-nuk është paraqitur as certifikate e pronësise, as kontrate qiraje nëse ka, dokumente këto të pakërkuara në këtë kriter.*

Komisioni, referuar dokumenteve të ofertës së ankimuesit, konstaton se në përmbushje të këtij kriteri OE ka ngarkuar deklaratën e tij cituar në pikën III.2.2. të këtij vendimi, duke përmbushur kriterin kualifikues.

Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë. KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik në rastin konkret, nuk është në përputhje me kriterin e kualifikimit të vendosur nga autoriteti kontraktor për plotësimin e këtij kriteri kualifikues të kapaciteteve teknike, pasi nga shqyrtimi dokumentacionit dhe informacionit të ardhur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, nuk rezulton që ky i fundit të këtë bërë një hetim të thelluar apo verifikim mbi deklaratimet e OE. Akoma më tej, Komisioni referuar Nenit 82, pika 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku citohet, se *Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.*, vëren, se legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në dokumentet standarde të tenderit edhe të drejtën e verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që brenda kuadrit ligjor ushtron të drejtën e tij mbi kryerjen e verifikimeve mbi vërtetësinë e dokumentacionit të ofertave si dhe monitoron me rigorozitet zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallrave, dhe mënyra e lëvrimit në kohë janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor përcaktuar dhe në kontratë.

Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.3. Në lidhje me arsyen e tretë të skualifikimit të ankimuesit: *2.3.5 Ofertuesi duhet të ketë ne pronesi ose ne përdorim kundrejt kontratës perkatese të noterizuar, mjete transporti të vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës si më poshtë:*

- *Te pakten një Automjet të pershtatshëm me kapacitet deri 3.5 ton për transportimin e druve të zjarrit.*
- *Te pakten një Automjet vetëshkarkues me kapacitet deri 3.5-7.5 ton për transportimin e druve të zjarrit.*

*Per automjetet në përputhje me kodin rrugor të paraqiten certifikatat e pronesisë, si dhe dokumentacioni perkates; siguracioni, leja e qarkullimit, aktin e kolaudimit të automjetit në dispozicion-2 mjete të paraqitura janë mbi tonazhin e kërkuar. AA75ITS-12.5 Ton deri në 18 Ton dhe TR7261K-10.3 Ton deri në 16 Ton..”*

III.3.1. Autoriteti kontraktor në DST ka publikuar shtojcën 7, 2. Kriteria të Vecanta të kualifikimit, 2.3 Kapaciteti teknik,

Pika 2.3.5 Ofertuesi duhet të ketë ne pronesi ose ne përdorim kundrejt kontratës perkatese të noterizuar, mjete transporti të vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës si më poshtë:

- Te pakten një Automjet të pershtatshëm me kapacitet deri 3.5 ton për transportimin e druve të zjarrit.
- Te pakten një Automjet vetëshkarkues me kapacitet deri 3.5-7.5 ton për transportimin e druve të zjarrit.

Per automjetet në përputhje me kodin rrugor të paraqiten certifikatat e pronesisë, si dhe dokumentacioni perkates; siguracioni, leja e qarkullimit, aktin e kolaudimit të automjetit në dispozicion.

III.3.2. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake** në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, **formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji**. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. **Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.**

Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënues për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

**i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;**

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

**6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe**

**dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

**7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.**

Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “d” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.[...]”

III.3.3 Komisioni vëren se referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të Ligjit 162/2021“Për Prokurimin Publik”.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të

detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Referuar pikës 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “**Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në përmbushjen e kriterit 2.3.5 në shtojcën 7, operatori ekonomik ka ngarkuar në SPE dokumentacionin e ofertës, shtojcën 8, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit ku në pjesën B. **DEKLARATË, Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, operatori ekonomik ankimues ka deklarur:**

- *Makineri e mjete. PO [X]*

*Nëse po listoni të dhëna konkrete.*

- *Linjë prodhim pelleti.*
- *Mjet transporti TR7261K*
- *Mjet transporti AA991CX*
- *Mjet transporti AA751TS.*

Akoma më tej operatori ekonomik ka bashkëlidhur dokumentacionin përkatës për automjetet e deklaruar.

*Mjet transporti TR7261 me dokumentet-Leje Qarkullimi e automjetit TR7261K, Kontrolli Teknik, Certifikatën e Kontrollit Teknik, certifikatë për transport mallrash, certifikatë e kryerjes së operacionit teknik, Taksat Vjetore për 2023 të mjetit dhe Policë Sigurimi të Detyrueshëm*

*Mjet transporti AA991CX me dokumentet- Certifikatë e Pronësisë, Leje Qarkullimi e automjetit AA991CX, Kontrolli Teknik, Policë Sigurimi të Detyrueshëm, Certifikatën e Kontrollit Teknik, Taksat Vjetore për 2023 të mjetit dhe foto ilustruese.*

*Mjet transporti AA751TS. me dokumentet- Certifikatë e pronësisë, Kontrolli teknik, Policë për sigurim të detyrueshëm, Certifikatën e kontrollit teknik, Taksat vjetore për 2023 të mjetit, certifikatë për transport mallrash, certifikatë e kryerjes së operacionit teknik, dhe foto ilustruese e mjetit me pajisje vetëngarkues e shkarkues.*

Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se operatori ekonomik ankimues në përmbushje të kriterit, *për disponimin Te pakten nje Automjet te pershtatshem me kapacitet deri 3.5 ton per transportimin e druve te zjarrit, dhe Te pakten nje Automjet veteshkarkues me kapacitet deri 3.5-7.5 ton per transportimin e druve te zjarrit*, ka paraqitur dokumentacionin sipër cituar nga ku rezulton, se operatori ekonomik përmbush kriterin kualifikues të autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë.

Akoma më tej operatori ekonomik ka paraqitur dokumentet për secilin mjet transporti nga ku rezulton, se përmbush kriterin në lidhje me tonazhin e tyre, dhe gjithashtu mund mjetet e transportit të ankimuesit mund të mbajnë ngarkesa mbi limitin e kërkuar, që do të thotë se OE ka mjete të nevojshme për realizimin e kontratës në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur të gjithë dokumentacionin në përputhje me kriteret dhe kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Për sa referuar pretendimi i ankimuesit qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e



*Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,*

### **Vendosi**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “ALCANI” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-88685-11-22-2023, me objekt “Blerje dru zjarri dhe Pelet, për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë”, me fond limit 3,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Rrogozhinë.
2. Autoriteti kontraktor të shfuqizojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues “ALCANI” SHPK duke e kualifikuar këtë operator sipas konstatimeve të mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ALCANI” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**

**Anila Malaj**

**Anëtar**

**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**

**Fiorent Zguro**

